

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
B21

VEHBI
BALA

BURIM
POEZIE


vjersha

SH-1
B21.

VEHBI BALA

BURIM POEZIE

vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

VEHBI BALIA

148
148

BURIM POEZIE

qjershm

Tirazhi 2000 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1977

Zemër mendje e veçohet
Parti e Prudë
prijse e shpirt i Shqipërisë
si xhaxha drejt lartësisë
shkon kurorës.

SHQIPËRI!

Fushë e kuqe, shkabë e zezë
me dy krerë,
yll i zjarrtë, rezendezë,
Shqipëri, moj lulekezë,¹⁾
shkëmbi lerë!

Tokë e larë djersë e lotë,
gjak vaditë,
buzë detit rrahur shqotë,
Shqipëri, kala në botë,
male ngritë!

Shpatëzhveshur duke çarë
historinë,
popull trimash luftëtarë,
lapidarët ngre pishtarë
për lirinë.

1) lule, kurorë

Zemër, mendje e vegjëlisë,
Parti e Punës,
prijse e shqyt i Shqipërisë,
si zgalem drejt lartësisë
shkon furtunës.

SHQIPËRI!

Parti e Punës, mendje e vegjëlisë,
Parti e Punës,
prijse e shqyt i Shqipërisë,
si zgalem drejt lartësisë
shkon furtunës.

Parti e Punës, mendje e vegjëlisë,
Parti e Punës,
prijse e shqyt i Shqipërisë,
si zgalem drejt lartësisë
shkon furtunës.

Parti e Punës, mendje e vegjëlisë,
Parti e Punës,
prijse e shqyt i Shqipërisë,
si zgalem drejt lartësisë
shkon furtunës.

1) Jofe kurorë

BURIM POEZIE

Pllajat kthehen në brezare,
xehet¹⁾ në metalurgji,
nafta-lumë, që rrjedh ujvare,
lumi-mijra kuajfuqi.

Njerzit ngrehin vepra t'reja,
veprat rrisin njerz të rinj.
Buk', çelik e drit' — beteja,
kthehen tok në poezi...

1) minierë

KANONIERËT*)

Parakalojnë detrave dy flota
me topa plim, avionë edhe silurë:
rrëfejnë forcën që t'u bindet bota;
në mos, ta kthejnë botën në qivurë.

Dhe përshëndeten si të egrat frota,¹⁾
të ndajnë si piratët pren' dikur.
Dhe përgatiten të shpërthejë sqota
e përmbi glob të sulen me zhumhur.

Ku vete njëra, aty tjetra shkon
dhe kudo ngulen aty kallin zjarr.
Po zjarr ndaj tyre urrejtja ndez duhi:

luftojnë vendet për pavarësi,
luftjonë kombet për çlirim kombtar
dhe ngrihen popujt për revolucion.

*) luftanijet e dy superfuqive

1) ordhi

MARSHI I BRIGADËS SË 27-të SULMUESE*)

Me zjarr sulmon nëpër beteja
Brigada e njëzeteshtatë.
Përpara për fitore t'reja
s'e ndal armik e as shtrëngatë.

Ne, bijt' e Shqipërisë,
për popull e Atdhe,
luftëtarët e lirisë
vërsulemi rrufe.
Të lidhur dora-dorë
punëtorë dhe fshatarë,
do t'i dërrmojm' prorë
fashistët gjakatarë.

Sulmo, sulmo, Brigada jonë!
Armiqt e egër shpartallo!
Për çështjen e liris' gjithmonë
fitore korrim ne kudo.

Ne, bijt' e Shqipërisë...

*) U muzikua nga Prenkë Jakova si marsh i Brigadës.

RRAPI

Në zemrën e qytetit të veriut,
ku linda i dëshiruar një shëndre
dhe shtegëtimin nisa të njeriut,
qëndron një rrap me kokën gjer në re.

Të thella i ka rrënjët ai në dhé
sikur heroi në popull dhe gjeniu.
Ndaj i qëndron murrërit dhe veriut.
përjetësisht me hijeshi të re.

Më lart pallate e oxhaqe u ngritën sot
se rrap me qytetin moshatar.
Por, prapë, ai mbeti, për të gjatë mot,
i së kaluarës një dëshmitar.
Brezni, që vanë, s'e harruan dot.
Pasardhësve ua lëmë më krenar.

IV. MIRËNJOHJE

Kalon, si kalimtarët e rëndomtë,
dhe rreth e qark si ata i hedh ti sytë,
por jo të gjith' si ti ndjejn' krenarinë,
tek shohin veten rrugës përsëdytë.

T'u zbardhën flokët dhe t'u çelën rrudhat
të thella dhe të ashpra në fytyrë,
por jo të gjithë e ndjejn' kënaqësinë
si ti, tek shohin gjurmët në natyrë.

Se mure ngrite shumë edhe çati,
se vetë u ngrite lart në hapësirë,
prandaj në ty e ngjatjetojn' njerinë
aq kalimtar' të dashur dhe të mirë.

RRUGËZA E BLINJVE

Buzëbrëmje. Flladi pranveror
nis e fryn liqenit gjer këtu.
Zjen sërish qyteti punëtor,
tëksa tutje skuqet qielli blu.

Derdhen parqeve dhe shesh më shesh
çifte, pleq, të reja dhe të rinj.
Duket se qyteti buzëqesh, —
gjallërohet rrugëza me blinj.

Ndër uzina dhe fabrika tej,
puna vlon dhe klasa djersën derdh.
Afshi qytetar na rreh ndër dej,
malli i vjershës, si dikur, më erdh.

Dhe në rrjedhën e një jete t're
rriten masat nga një brez në brez.
Rrugëza e blinjve, sot si dje,
na rinohet prap' në çdo mëngjes.

I.

TE MITRI I KORONËS*)

Ne ndoqëm rrugën që kish rrah' Poeti,¹⁾
tek zgjohej Makja²⁾ — një pëllëmb' shtëpiza.
Ai, kaluar çante shtigjet driza,
paçka se trandej dheu e shfrynte deti...

Këtu të vegjlit nipër m'i ka ndjellë
mësuesi bërë si një grusht kokallë.
O, zjarri i arbit, atë e mbante gjallë
e malli i «Motit t'madh»³⁾ nga shekujt sjellë.

*) S. Demetrio Korone, në kolegjin e të cilit, (S. Adrian) dha
mësim arbërisht Jeronim de Rada afro nëntëdhjetë vjeçar.

1) Jeronim de Rada (1814-1903)

2) Fshat i vogël arbëresh, në krahinën e Kozencës së Kalabrisë, 9 km. afër S. Demetrio Korones. Aty lindi poeti.

3) Kështu e quajnë arbëreshët epokën e luftërave të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Gj. Kastriotit. Skënderbeut, kundër dyndjes osmane.

Te Mitri i Koronës jemi ndalë.

Ai duket se na ligjëron sërish:

«U shprish ky gjak i arbit!»⁴⁾ Por s'u prish.

Në shesh na tingëllon e ëmbla fjalë.

Mindaljet⁵⁾ të përcollën drejt varreze...

Por sot të ngre shtatore⁶⁾ Shqipëria

dhe me hare të çiltër poezia

ty të rrethon si një kuror' me rreze...

- 4) Këto fjalë i atribuohen poetit tek po vdiste.
- 5) Bajamet. Thuhet se ditën 28 shkurt 1903, kur njerëzit po përcillnin kufomën e poetit për në varreza, fryu një erë nga malet dhe tundi bajamet, të cilat ranë mbi arkivol.
- 6) Shtatore e punuar nga Artisti i Popullit, skulptori Odhise Paskali, dhe e vendosur në mes të fshatit, në përkujtim të figurës së poetit nga vendi i të parëve të tij.

dashuri e nderur herjet
për këmishëkuqt³⁾ me fletë
a Mërinëzën kopilje⁴⁾...
Nga një jone te një tjetër,
si jehonë e përtej detit
vijne këngët popullore
dhe «Shqiponjat partizane».

3) aludohet për këmishëkuqtë garibaldinë, në radhët e të cilëve ishin edhe shumë arbëreshë.

4) vajzë, në arbërisht.

III

NË VILA BADESA*)

Jam «dushku i vetëm» në Vila Badesa?
«Më plaku» në shokët më thonë se mbeta?
Po s'epem aq lehtë, o gjindje, qe besa:
m'e ëmbël akoma më qesh tani jeta...

I dua të vendit, se strehë më dhanë,
se botën së bashku me ta e kam çarë;
po Arbrin e ruajta — stërgjyshit ma lanë —
në zemër si pengun të shenjtë e t'pandarë.

Më plakën ne patëm një trim si falkua.
Nga nusja dhe djali na erdhi dhe mbesa,
Të tërë, pra, jemi arbresh' të kulluar,
s'jam «dushku i vetëm» në Vila Badesa.

*) Fshat arbëresh në Abrucet, themeluar më 1744 nga banorë të Piqerasit të Himarës.

BUZË ARNOS*)

Buzë Arnos erdhëm përsëri,
pas tridhjetë e ca vite shkuar.

Asgjë,

në këtë dhé,

më ngjan s'ka ndryshuar:

luks i pështirë, e zeza varfëri —

një kundrështi e përbetuar

me momentet shkëlqimtarë.

Këtu, duke kaluar,

Halimi¹⁾ i mërguar,

Qemali²⁾ i zjarrtë dhe Shejnazja³⁾ e re,

me mendje e zemër në Atdhe,

kanë ëndërruar

revolucionin çlirimtar.

*) Lum që kalon përmes Firences

1) Halim Xheho filloi studimet universitare në Firenze

2) Qemal Stafa filloi studimet universitare po aty

3) Shejnaze Juka bëri mësimë të mesme në një kolegji të atij qyteti

Këtu, poeti i ri,⁴⁾
me gjak të valë,
shkroi «Yje mbi greminë».
Sa krenari
t'u ndjekësh gjurmët shokëve shqiptarë
që shkrinë veten për lirinë!

Qyteti i luleve në këtë dhe
nuk paskërka ndryshuar,
po paskemi ndryshuar ne!


Dikur,
Andre,⁵⁾

ne vinim si të truar
të merrnim dije t'lartë
në dhé të huaj!

Dhe bënim zemrën gur,
duke dëgjuar tjetrin kryelartë
«Të zjarrtë trima» të na quajë
«veç të pagdhendur në dituri,
të pandriçuar nga qytetërimi...»

Hej, ç'bëri ky revolucion shqiptar!
Sa lart e ndjejmë veten sot, Andre!
Dhe janë gjallë
me ne

4) Gaspër Pali kreu studimet universitare po në atë qytet
5) Andrea Varfi, bashkudhëtar i kërkimeve letrare në atë qytet, në shtator të vitit 1975



Halimi, Qemali, Shejnazja, Gimi.⁶⁾
Ndaj sot këtu, tek rrimë unë e ti,
për ta po shprehim evari,
si nxënës dhe shokë mendimi.

Rrjedh ujt e Arnos i rrëmbyer.
Na janë shtuar brazdat mu në ballë.
Na dhemb në mur të shohim kryq të thyer
dhe pranë aty një grua të zhgërryer
a një djalosh nga droga i gërryer!
Ku vete, deh, ku vete ti,
moj «botë e ditur», vallë?
«Mësuesit» tash në «nxënës» janë kthyer,
ndaj nëpër botë pyesin kureshtarë,
se qysh qëndrokemi të papërlyer
dhe kaq humanitarë,
në këtë shekull të «zhgënjyer»,
qysh ec revolucioni fitimtar!

Buzë Arnos erdhëm përsëri,
pas tridhjetë e ca vite shkuar,
që të kërkojmë nga gjeniu shqiptar
çfarë është e jona për t'u trashëguar.
Se Arbri gjak edhe gjeni,
në botë kish përndarë,
ndërsa vetë ai, për bukë edhe liri,

6) Pseudonim i Gaspër Palit, shok i Qemalit në atë kohë

të drejtë e dituri,
qëndronte i përvëlur...
Por çau me pushkë e këngë hapësirat
dhe jetë i bëri në stuhi dëshirat.

Shfletojmë dorëshkrime — shkronja e rreze...
Shpalosen kohët — vepra të një shprese...
Më ngjan se janë përtëritë
De Rada, Dora, Vasa, Gega e rrinë
të kuvendojnë tok,⁷⁾ tek Shqipërinë
të rrojë e shohin t' lirë e tërë dritë.

Buzë Arnos erdhëm përsëri
dhe, sa më larg ndaj teje jemi ne,
na djeg m'i zjarrtë malli për Atdhe,
për ty, e ëmbla Shqipëri!

7) Në Bibliotekën Kombëtare të Firences u gjetën dorëshkrime me vlerë të Jeronim de Radës, Dora d'Istrias, Pashko Vasës dhe Karl Gegës

BETIMI I PALESTINEZIT

Po lahet Palestina ime gjak.
Nga anë e anës rend sionisti pis,
me armë e ar mbështjellur gjith faiz,
dhe më dëbon nga vatër e jatak.

Ndërsyer edhe majmur vis më vis,
më shtrohet këmbëkryq mbi nder e prak,
më zë porsi rrëshaja¹⁾ frymën njak
me kapital e me lake ibliz.²⁾

Por dhe në mbetsha i vetëm në kët' dhé,
ku linda dhe u rrita punëtor,
me grykë pushke do të shkrep rrufe

përmbi sionist e imperialist gjaksor.
T'i ngordh edhe t'i flak ato shkërbe,
pastaj të vdes mbi dheun e lir' përor.

1) lloj gjarpri.

2) tinzar, aludohet për revizionistët socialimperialistë.

IRLANDA E VERIUT, PËR JU SKËTERRË...

Nën këmb' ju digjet toka dhe mbi kokë
ju nxihet qielli. Dita bëhet sterrë.
Pushtues anglezë, ne ju kallim tmerr,
gjersa të mos qërohi nga kjo tokë!

Luftojnë e bijnë motra, vllazër, shokë,
në prak e shesh, qilar, çati e derë.
Irlanda e Veriut, për ju skëterrë,
për ne një djep, një vatër dhe një trokë.

Na bie një dhe qindra ngrihen varg.
Kalon një mot dhe vjen një tjetër mot.
Kalon një brez dhe vjen një tjetër brez.

Fitorja jonë e shtrenjtë s'është larg.
Ky gjaku ynë i valë s'është kot.
Liria do t'agojë një mëngjes.

IRLANDA E VERIUT, PËR
JU SKËTËRRE...
PËR TY, BRAZIL!

Në plantacione, pyjë dhe miniera,
ne derdhëm djersë, gjak e brazilinë;¹⁾
na treti mundi dhe na preu kolera,
duke pësuar shtypjen dhe urinë.

Ndaj jemi zhgulë andej e ngjit' në sierra,²⁾
ndaj luftën kemi nis' me tiraninë.
Se prap edhe për ne do zbardhë pranvera,
pa fronin, lterin, padronin, jankinë.

1) lëndë ngjyuese e kuqe, që nxirret nga bima e quajtur «brazil»

2) mal

Me pushkë e këngë, Pédrosi dhe Klara,
nga siërra zbresin trima partizanë.
Duke luftuar bie tej kitara,

duke kënduar lufta zien çdo anë.
Për ty, Brazil, sulmojmë tok përpara,
ne, bijtë e vegjëlisë, brazilianë!

KOLONA

Marshon kolona n'shpate dhe lugina,
ndër male veshur me koriye e pyje.
Ndër kreshta fshik e egër suferina,
në terr ndriçojnë qiellit vetëm yje.

Të dridh kjo mardhë. Syt' nga gjumi qepen.
Të thahet gryka. Këmba më s'të mban.
Por sheh tek shokët pranë e pranë s'epen
dhe ti krenar si bredhi rri kallkan.

Ty malet legjendare të këndellin
një mburrje kaq të thellë edhe të dlirtë,
sa të pushtosh majmalet vetë e qiellin
me zjarr të afshit stërgjyshor në shpirt;

një mburrje e birit t'popullit të lashtë,
të zgjuar, trim, të thjeshtë e zemërbardhë.
O toka jonë, ndër shkëmbinj të vrashtë,
n'stërvitje që të mbrojmë kemi ardhë.

Marshon kolona si një rrjedhë ungji
mendimesh edhe ndjenjash njerëzore
përmbas flamurit t'ngritur në liri
dhe lumturi të botës punëtore.

N'atë etje e lodhje, mardhë edhe dremitje,
nga maja n'maje, ballë suferinës,
lartohet kënga si në përtëritje
dhe larg jehon tërthoresh e luginës.

MËSUESIT USHTAR*)

Një çant' mësuesi, libra dhe ditar,
ku shkrove jetën tënde në aksion,
një radio, që ti zërin e Partisë
t'ia çoje fshatit më të thell' malor,
në gji një letër, që të thirri ushtar,
i vetëm more shtegun thik' shkëmbor,
i vetëm duke rendur ball' duhisë,
për të festuar të kuqin Nëntor
atje, me nxënësit e tu të parë.
S'të ndali vatra familjare e ngrohtë,
qyteti dritandezur dhe hare,
por me ndërgegjeje, asaj mbrëmje t'ftohtë,
si komisar i kuq dhe si pishtar,
pasues i Ndrecës revolucionar,
u nise larg mbi kreshta... Edhe re,
mësues që mbete i gjallë ndër ne!

*) Ismet Sali Bruçaj

Na bie një, por qindra njerëz të tjerë
sot ngrihen në të shtrenjtin tonë Atdhe,
stafetën duke çuar tej me nder.
Në shkollë i riu mësues të ndoqi pas —
një shok që asnjëherë nuk t'u nda —
dhe në repart, ku t'u radhit yt vlla,
ty nuk të ngeli vendi bosh një ças.
Marshon revolucionin pa ndërprerë
dhe drita e tij shkëlqen më fort kudo.
Ka rrënj' të thella populli hero.
në këtë dhé me djersë e gjak vaditë.
Po, nxënësit e tu kan' për t'u rritë
pishtar' të rinj, si shembull ti u dhe
mbi kreshta malesh e përball' duhisë,
mësues hero, o biri i Partisë!

DOMËN

Një ditë zbardh ashtu si zbardh çdo ditë —
njëzeta e prillit shtatëdhjetepesë.

Por hyri kjo në Domën, shekuj pritë,
e shkruar mbi një çezme aq thjeshtë.

Në zemër malesh ai na qe përflakë —
katund i rrahur shqotë e tramundanë.
«Zotrim» e thirrën ujqërit romakë,
«Demir» e ndollën vjedullat osmanë.

Veç mbeti shkëmb ky Domën i padhënë
si Drishti, aty pranë, një kështjellë.
Romakë, osmanë, t'egrit saraqenë,
fosile u bënë atje, me turp mbështjellë.

U sulën dhe fashistët gjakatarë
dhe, si të parët, hëngrën gur e dhe.
Heroi Tom Kola, yll ndër luftëtarë,
qëlloi mbi ta si qielli shkrep rrufe.

Me lule maji, kohrave pagane,
stoliseshin kasollet në pranverë.
Por kjo pranvera jonë partizane
të reja këngë e vepra sjell përherë.

Pushtetin popullor dhe ujë bjeshke
ëndërroi plaku qindvjeçar një jetë,
zhuritur për liri dhe etje rreshkë
në këtë copë Atdhe me ball' në retë.

Këndon rapsodi për dollinë e parë
që çoi Enveri me uj' malësie:
«Parti e dashun, ty të qofshim falë,
që bjeshkës ngrite gurrë prej freskie!»

Ndaj ditë, që kalon porsi çdo ditë,
njëzeta e prillit s'është kësaj kreshtë,
ndaj qullen e lodrojnë ashtu fëmijët
rreth çezmës, që sjell ujin aq thjeshtë...

BALADA E PESHKATARIT

Mbi liqen të qetë

peshkatari shkon.

Lundra e tij e letë

valët i përshkon.

Ra e paqët nata.

Yjet ndrisin varg.

Valët çan lugata.

Rrjeta hidhet larg.

Fshati ra në gjumë.

Veç një dritë pret.

Lundra përmbi shkumë

tej e tej rrëshqet.

Rrjeta mbushet plot.
Lundra plym rëndon.
Peshkatari i fortë
dritën e vështron.

Kur, pa pritur, shqota
nis e fryn duhi.
Shuhen yjet. Bota
thua krejt u nxi.

Dallgët çohen peshë
egër mbi liqen
dhe me to përleshë
lundra shkon e vjen.

Brof në këmbë fshati,
burrat i kërkon.
Shqota kot ia pati.
Ata s'i frikon.

Dhe nga grykë e rrymës
njerzit rendin tok.
Ball për ball' fërtymës
lidhen shok me shok.

Njerzit, lundrat, rrjetat
kthehen prap' në breg.
Sa fuqi ka jeta,
kur dikush e prek!

Dhe, si vjen pa pritur,
ashtu ik e shkon
shqota e turitur
valët q'i tërbon.

Drita, e pashuar,
tërë natën mbet.
Vasha e fejuar,
peshkatarin pret.

MITURA E MITURA DASHURIA

— Nuk je borë as nuk je brymë,
por je dritë edhe je frymë,
që më ndrit e që më ngroh,
vashë; o vashë, kur të shoh!

— Nuk jam frymë as nuk jam dritë,
por jam brymë e borë e ngritë,
që të ftoh e që të ngri,
djalë, o djalë, që shtang më rri!

— Mos je sutë a po mërquinjë,
lerë e rritur në shkëmbinj,
që nuk ditke brengë e mall
dhe më lë të ndezur all?

— Nuk jam drizë as nuk jam sutë,
por e egër edhe e butë,
si të gjithë, që luftojnë
dashurinë të fitojnë.

I MOSHUARI DHE E MITURA

(Mahi popullore)

— Qenke rritur, moj e mitur,
dhe nga duart më je shqitur,
sa, dikur, ta kisha ditur,
nuk të kisha më thërritur,
as dhe pritur dhe vaditur,
por mëritur, neveritur.
Tash që ti më je mërguar,
pa kujtuar e menduar,
po më dukesh fort e zgjuar,
zemëruar e llastuar,
e pazënë dot me duar,
si një shënjëz e praruar.
Ja po rend pas teje sot.
Rreh të gjej e s'të gjej dot.
Mirë e shoh se rënda kot.
Por do t'rendi mot për mot,
ndaj mos qesh, mos derdh as lot.
Burri fjale nuk të lot.

— Kot po rend e kot e ke
si shkërbe që ndjek një pre.
Ti një burrë e unë e re,
ti si vjehërr, unë — re,
unë e mitur, ti i ve —
gas i botës përmbi dhe!
Duke rendur si zagar,
do t'rrëzohesh me zarar;
ndaj hiq dorë nga ky zar!

S'bëj pazar me një zuzar.
Por, firar, në s'gjen karar,
marr litar e t'lidh kular.
Shokun tim e kam vllastar.

BLUZA, TRIKOJA DHE GRANITI

Nëna po qendis një bluz' të bardhë.
Lule t'kaltërta mëndafshi end.
Në çdo lule duket një lumbardhë
me lumbardhën shtrohet në kuvend.

Për të bijën shpirtin derdh në lule,
pritmin më të bukur ia qendis.
E rrethon aq ëmbël me pekule
dhe si mituri e nanuris.

Endte vajzë ajo kështu një herë
shpresën më të thell' për lumturi,
por venitej malli në pranverë
me duvak të bler' për nusëri...

Thurr edhe e bija larg shtëpisë,
në aksion ku shkoi me shoqe tok,
ëndrrën më të çiltër t'dashurisë,
ëndrrën për një jetë, për një shok.

Zgjodhi shok atë që deshi vetë
dhe për të një triko thurr ajo,
që në shtat për dimër ai ta ketë,
se gjeologu bredh e bredh kudo.

Nëna po qëndis një bluz' të bardhë.
Larg shtëpisë edhe e bija thurr.
Por gjeologu maleve në mardhë,
emrin vashës ia skalit në gur.

Ai për bluzë e triko s'ka menduar,
veç nga malli vashën e skalit.
Vashën don, ashtu t'përfytyruar,
ta përjetësojë në granit.

E BRISHTA

Gërshetat lidhur dhe bustinën ngjeshur,
mbërthyer jakën, pushkën fort shtrënguar,
rri gati, syrin pish', për t'u përleshur
te posti i llogorit të caktuar.

Në auditor e vreje aq të brishtë,
gërshetat derdhur, bluzën bardh' dëborë,
si ëndërr midis lilash në lulishtë,
si yll mes yjesh ballit në kurorë.

Nga auditori e sheh n'llogor të shkojë,
me ballin lart të çajë nëpër jetë.
Kjo vajzë e brishtë', që kthehet në mburojë,
është komisare e kuqe e vërtetë.

K R I Z A

I ngjitet kapitalit kriza rrodhe,
e bren nga brenda porsì një livrizë.
Manjatët për shpirtqole hedhin krodhe,
me krodhe kusuferët¹⁾ bëjn' devizë.

Dhe rritet kapitali tok me krizë
dhe kriza kthehet pa shërim në rrodhe
dhe njerëzinë e ngordh me dhun' të zisë.
Uria s'thuhet veç me byk e vodhe.

Dhe shtrihet tejpertej papunësia.
Me kusëri, hashash, vodkë e havjar
sëmuret shoqëria e rënë prë.

Po mllefi lëmsh mbështillet nga mëria.
Shpërthen revolucioni çlirimtar
dhe kapital e krizë i zhin mbi dhe.

1) intrigantët

E K S O D*)

Që nga vendlindja ata jan' shpërngulë,
gjindjen e zemrës ata kanë lënë.
Si degë të një rrënje janë zhgulë,
si bij të truar të së dhimbshmes nënë.

Në shtegtim për punë ata janë vënë,
nën thundër kapitali jan' përkulë.
Vargan i uritur, në mendime rënë,
përballin fyerje, vojtje dhe gërbulë.

A thua s'paskan endacakët shpresë?
Mundimi i tyre thua shkoka huq
dhe prap' do kalben dherave firarë?

Jo, jo. Po lidhen tok ata me besë,
po i bashkon më një flamur i kuq —
internacionalizmi proletar.

*) shpërngulje, mërgim.

THELLËSITË

T'ua kesh zili gjeologëve,
që ngjiten lart ndër male
dhe, thellësive t'dherave
kërkojnë minerale.

T'ua kesh zili detarëve,
që, detrave shtat' ballë,
ndaj dallgëve e furtunave
qëndrojnë ball' për ballë.

T'ua kesh zili pilotëve,
që, si shtegtar' të rrallë,
ndër hapësira qiejeve
fluturojnë atje në ballë.

Dhe, si ata, tej shëkujve,
kërko t'zbulosh thesare
në vetëdije t'popullit —
virtytet shqiptare!

THE BEST
KU VENI JU, MENDIME?

Ku veni ju, mendime?
Atje ku dora trime
shpërgjum thesare
të fjetura me shekuj n'fusha e male,
atje ku ngritën
uzina
dhe godina,
që rrokin qerthuj me dëshira,
vullnete dhe endira,
atje ku rrymat dritën
përhapin me furi
në jugë e në veri,
atje ku më gjëmon traktori
dhe ku përshkohet plori
tek çel të reja brazda ndër ugarë,
atje ku shokët krijimtarë,
të ndezur në frymëzime,

krijojn' për breza t'rinj shqiptarë,
atje ku roja trime
përball' ganecës¹⁾ bishë,
përgjon me syrin pishë,
atje më shkoni ju, mendime...

MONUMENTI

Rreth shirë i shpeshit i vjeshtës dhe e paston
i shpeshit i dimrit dhe e lishkron.
I shpeshit i pranverës lulet ia flladit,
me treze delli i vresë e përditit.

Gëndon përballësit ashtu koron
monumentit i parixant shqipar.
Koha që rrëzohet e bën të madh shitor
në lëndinë treze atondit shkëmbor.

Përballësit i shpeshit i vjeshtës dhe e paston
i shpeshit i dimrit dhe e lishkron.
I shpeshit i pranverës lulet ia flladit,
me treze delli i vresë e përditit.

1) figurë e përbindshme e përrallave shqiptare

MONUMENTI

Rreh shiu i shpeshtë i vjeshtës dhe e pastron,
resh borë e dimrit dhe e fisnikëron,
fllad i pranverës lulet ia flladit,
me rreze dielli i verës e përndrit.

Qëndron përjetësisht ashtu krenar
monumenti i partizanit shqiptar.
Koha, që rrjedh, e bën më madhështor
në lëndinë rrëzë sfondit shkëmbor.

ZOGJTË

M'i ka ënda zogjtë e vegjël në lëndinë,
kur qukasin, cicërijnë gush' më gushë.
Drithmat e dëshirës mpleksin melodinë, —
flatra u jep kjo jetë e ëmbël, gas i mbush.

M'i ka ënda zogjtë e vegjël trumë-trumë,
tek përsillen rreth një peme, rreth çatisë.
Zgaqen lulet, derdhin erëzën në kumë,
ledhatuar butë e butë prej puhisë.

Por shqiponjat nëpër kreshta, nëpër maja,
m'i ka enda fort më shumë kur përgjojnë;
sogjetare, zogj e lule, male e pllaja,
tokë amtare e qiell të lirë përqafojnë.

KONTURE EPIKE

Dhe shpërthen një brinjë mali
tej, në Fierzën heroike.
Në konture aq epike,
lind vigan hidrocentrali.

Por m'e madhe se sa diga
klasa ndërtimore rritet,
që përçon fuqi prej drite
n'ato curra, n'ato biga.

NË KUVENDIN E POEZISË

Poezia

Ti, plis i dheut arbëror,
ti, bulëz gjaku stërgjyshor,
o fjalë e verbit amëtar,
o flakë e shpirtit këngëtar,

nga dheu arbëror buron,
nga gjaku stërgjyshor kullon,
me verbin amëtar të ri
ti thuresh, këngë, zjarr në gji!

Poeti

Revolucioni t'ri të mban.
Me klasën për të ardhmen çan.
Partia si fanar të ndrit.
Për jetë populli të rrit.

Armiqtë sulen me tërbim,
por ti krijon më me guxim
dhe vetë shkrihesh përgjithmonë
si këngë në revolucion.

NE KUVEJNDIN E POEZISE

Poesia

Ti pjesë dheut arborit,
ti pulës gjaku shpirtësor,
o lirisë e verbës amëtar,
o lirisë e shpirtit këngëtar,

nga dheut arborit buror,
nga gjakun shpirtësor kullor,
nga verbës amëtar të ri
ti thirrës këngë, zjarri në një

Poesi

Revolucioni i ri të mbarë,
Me klasën për të ardhmen e ar.
Eritë si fëmijë të ri,
Për një popull të ri.

Diellin kemi trokë
me revolucion,
nda) na ndal në shokë,
edhe na tiron.

PRANVERA E SHOKËVE TË MI

Na buloi qershia.
Bari mungulloi.
Hej, çka ndjell rinia,
që na vate e shkoi!

Pranverë natyra —
puna zjen kudo:
mijra tinguj, ngjyra,
zemër ti këndo!

Ishim burrëruar
ende fort të rinj.
Jemi kaq rinuar
tash që jemi thinjë.

Diellin kemi rrokë
me revolucion,
ndaj na ndrit ai, shokë,
edhe na rinon.

PRANVERA E SHOKËVE TË MI

Na doli qeshja
Bari nanguilloi
Hej, çka ndjeshë rrisi
që na vate e shkollë

Pranverë natyrisht
gura xhen kudo:
natyrisht natyrisht
këmbër ti këmbër!

Ishte për të
ende fort të rinj
jeoni hap rrinat
dash që jeoni thirrë

SHQIPËRIME

NJË ADMIRUESI TË DORA D'ISTRIAS*

— Ode —

Të mërguar, pa Atme,
kur, mbi varr t'braktisur, i huaji vendoi
një lule, i përdëllyer,
ne qanim ngashëryer
dhe zemra më s'kërkoi.

Por një ndjenjë e papritur
na thotë se dhimbja mbaroi tash për ne:
të kem' besim na bëri

*) Poezia u botua për të parën herë në vëllimin «Dora d'Istria e la poesia albanese» («Dora d'Istria dhe poezia shqiptare»). Venedik 1869, nën titullin «Z. Bartolomeo Çeketit për studimet e tij mbi veprat e Elena Gjikes» (sipas informacionit të Jup Kastriotit).

jehona e një zëri
bujar nga tjetër dhé.

.....

Mbi shëmbëllesën Tënde
të mermertë, për Shqipëri nderim,
kurorës së pashuar
në shekuj përjetuar
vë lule për amshim.

.....

Po Skënderbeu, i vetëm,
ordhisë së qenit turk i kalli tmerr,
kur erdh kjo egërsirë
dhe qiellin duke nxirë
shoi gazin ton' me vrer.

Ne, nga mërgimet tona,
blatojmë ato ditë të bardha nga mot
dhe Ty, që nder gjithmonë
i solle Atmes zonjë,
të përshëndesim sot.

PROLETARI*)

Qenke bërë kockë e trokë,
o i gjorë që, pa tokë,
pa shtëpi, pa gjë, pa qarë,
pa dërrasë, si të vrarë,
të zvarisin gjer në dhé
ty që gjakun derdh për ne.
Gjuh' këmbora ty s'të ka
e pra bukën bota t'ha.
Ti dërrasa pret prej qarri,
por si dhé të shtijn' te varri.
Shul¹⁾ i bukur i jet's tënde

*) Vjersha mban edhe titullin «vajtimi i atij që nuk ka». Originalin arbërisht të kësaj vjershe e botoi J. Ferrarri, me përshtatje në shqipen e sotme nga K. Kamsi, te «Buletin i shkencave shoqërore», Tiranë, 1959, Nr. 1. Një ripërshtatje në shqipen e sotme kam botuar te «Shkencat shoqërore në shkollë», Tiranë, 1967, f. 187-189. Këtu po jap përpunimin në vargje të rimuara tetërrokëshe.

1) dru i hollë e i drejtë. Shprehja «Shul i bukur i jet's sate» ka kuptimin «Mbështetje e bukur e jetës sate»

dega e lisit është me lënde,
degë që rrufeja zu
dhe në truall fill e vu!
Nëntë muaj i sëmurë —
vdiqe etur, vdiqe urët.
Sëmurë ishe dhe të lanë
pa mjekime, pa tëbanë.
I begati, zemërgur,
po qe kali i tij sëmurë,
bën mjekime të mëdha,
se te kali mendjen ka.
Kali vuan? E shëron.
Është i egër? E pajton.
Dhe në kali vjen dërsirë,
me pëlhur' ka për ta fshirë.
Furça pluhurin rrëmben.
Krifja kalit i shkëlqen.
Shumë i jep tagji të hajë,
se kujdeset fort ta mbajë.
Aq ka mall për atë kalë,
sa pasqyrë bën një stallë.
E rrethon me dashuri
si n'altar një shenjteri.
E stolis me rrobot ar.
Kurse ti, një trim bujar,
djalë i rritur si llastari,
më i dashur se ushtari,
bukë e gas, kur pate uri,

s'gjete kurrë si njeri.
Gjumi dhelprën zë nën dhé,
zogu i qiellit ka fole,
kurse ty, o bir njeriu,
të rreh breshëri dhe shiu.
Vetëm ty s'të ngroh dot zjarri,
ty cullak të shtijn' te varri;
gun' të dhirtë pate veshur,
të mos dukeshë i zhveshur.
Boshti s'tori, vegja heshti,
gjë e mir' për ty nuk reshi;
doje t'ngordhte dhi e shkretë
që të bëje një xhaketë.
Dhent' i mbajte, bëre vathë,
por nuk pate mish as djathë.
Ti shkadhite dhe rrëmove,
ti tëharre vreshta e vole,
shtype rrusht me punë e nder,
por s'shijove gllënkë verë.
Katër her' të çoi katundi
në ushtri, armikun mundi
dora jote, që u ngri.
Por si t'vlarë ty tani
të zvarisën gjer nën dhé,
ty që derdhe gjak për ne.
Fiq të ëmbël ti qërove,
gojën por s'e ëmbëlsove.
Ti qërove ullinj, por, vaj,

hëngre lakërat pa vaj.
Gjak t'u rrop kurrizi shtypë,
kur n'kripore solle kripë,
por, sa more një patate,
kripë për ta kripur s'pate.
Kallon po ta shoh te dora,
që s'u tret si tretet bora
në kusi, që zjen nga zjarri
ndezur flak' me dru prej qarri.
Kalloja s'të tretet dot.
Ik nga ti ai që gasplot
rron i lumtur, pa mundim,
dhe për ty s'ka përdëllim,
as pikllohet e, pa t'keq,
gjakun tënd në pipë e heq
me një valë tym të letë
nën një qiell ku s'duken retë.
I begati t'vrejti çeren
dhe kryelartë e kyçi derën,
vaj medet! Që të jetoje,
duhej djersë e gjak t'kulloje.
Dromcë prej tryezës së begatë
goja jote nuk e pat,
kur të pasurit nga ti
shtonin plëng e katandi!
Që për ne, o katundar,
një burim për aq thesar,
që një krua që mbuloje

tokat dhe në ar i ndroje.
Krymb mëndafshi ti na qe,
me mëndafsh na mbushe ne.
Të plandosi te përroi,
pasaniku e të harroi.
Mëmë plakë, birin s'qan
që mizoret mote t'vranë?
Shpata zemrën s'ta shporon?
Gjak nga zemra s'të rigon?
Zhveshur barku yt e nxori,
zhveshur barku i dheut ta mori.
Qetësohu, teri lotët,
deti është ahte plot!
Jeta jonë, tis hareje,
do të ndrisë pas një reje.
Mëmë e dhembshur, mos u çirr!
E di, vallë, se yt bir
është dielli, fuqiploti,
që do t'feksi tek vjen moti,
tërë botën ta ndriçojë,
njerëzit t'i zbukurojë?
Është rrufe, që, kur gjëmon,
rreptë armikun e qëllon.
Jo, njeriu mbi njerinë
s'do të rrojë si një ditë,
por, bashkuar, do t'arrijnë
dheut t'ia nxjerrin pasuritë.

FILIP SHIROKA (1859-1935)

NË KAMBË, SHQYPNI!*)

O Atdhe në fat të zi,
shpatën nxirr, yrysh në luftë!
Fryn duhia, erret qielli,
të mëdhenjt e kësaj bote
n'damin tand janë përbetuem,
trolli yt asht kërcënuem,
asht poshtnue hieshia jote.

*) Vjersha e shkruar italisht dhe e botuar në një organ shtypi italian, mban titullin «**Me rastin e demonstratës detare në Ulqin – Në armë, Shqypni!**» dhe datën 20 shtator 1880. E përktheva në gjuhën poetike shqipe të autorit. Le të vrehet ngjashmëria e kësaj vjershe me «**O moj Shqypni!**» të Pasko. Vasës!

Amazonë fatmadhe, e bukur,
dikur qe e lirë, krenare.
Gjindja e huej, e dridhun frige,
ty flamurin ta nderonte
e çdo faqe historie
namin tand ë përkujtonte,
ta kremtonte trimëninë.

E shkujdesun, e pandershme,
tashti mbledhja e të mëdhenjve,
shtruem ndër salla mbretënore,
fatet tua ka shestuem
e në plojen¹⁾ tande ndau
bijt' e tu, veshjet e tua,
tue i ba kortar-kortar!

Nuk ndigjove? ... Në kufij
avulllore e bombe arrinë
rradhët tua me i përçamë,
me fuqi ma se tirani.
Gjindja sllave, dashakeqe,
don me t'ba shërbtore e skllave.
Nji Kongres kët gja pleqnoi.

Çohu, pra, dhe në rrezik,
pa vonesë e pa ngurrim,
paç guximin për këshillë

1) kërdi, gjakderdhje.

n'orën tande ma t'vështirë!
Si trimneshë shpalo flamurin
edhe ban të ngrihet nëlt
i borijave kushtrimi!

Bini, burra e sokola,
besa arbnore ju bashkoftë,
i së nesërmes dyshimi
e mëshira e dheut tonë!
Kush s'rrok pushkën qoftë turpnuem!
Prej altarëve u shpalltë,
Luftë e shejtë! Luftë e shejtë!

O Shqypni! që s'di ç'asht friga,
o luftare, e madhe asht prova,
por ma i madh në trimëni
asht ky pezmi i bijve tu.
Ruej me pushkë në malet tua
të paprekshme, të pandashme,
ti lirinë e trollit tand!

Por në qoftë se fati i zi
prapë të qet në zgjedhë robnie,
oh, Kongresin e Berlinit
turpi e mbloftë!... Ti guximin
e dishmove ndaj anmikut
e të drejtën që ke pasun
prapë e ke për kohë që vjen!

JU MBART TË GJITHËVE...*)

Ju mbart, o njerëz të mirë, të gjithëve kaluar,
me ju' i kam jetuar aq hove e shkatërrime,
kam bërë një ujvarë me lotët e vërshuar,
si kulla lart jam ngritur nga tuajat vegime.

Dhe në qëndroj i fortë, me ballin në zenit,
arsyeja është' se kurrë nga qenia nuk të shqit,
o drithmë e shpirtit t' masës, që rritesh me vërtik
e m'rrok, themel graniti, me dejet si çelik!

*) Shkrimtari rumun me origjinë shqiptare e shkroi këtë vjershë më 5 shtator 1942, kur kishte filluar Lufta e Dytë Botërore dhe fashizmi po bënte kërdi mbi popuj e vende të ndryshme. Ai e përfytyron vetveten si bir të masës dhe si shprehës të shqetësimeve e të vegimeve të saj. Vjersha u shqipërua nga origjinali rumanisht.

BALADË SHQIPTARE*)

Biri i pashës nga Janina
kalit t'zi i jep të pijë,
tek për uj' te lumi vij
me bucel' mbi krye Despina.
Por nga mali kreshtës ruan
e luginës Gjergji vren
edhe turkun edhe gruan.

Biri i pashës nga Janina
prej kraharorit lule nxjerr

*) Poeti përparimtar i fshatarësisë rumune, Gjorgj Koshbuku, mburr këtu karakterin e shqiptarit Gjergj, i cili, kur sheh si biri i pashës nga Janina rreh të shtjerë në dorë Despinën, bijën e atij vendi që Gjergji e ka bashkëshorte, dhe kjo pranon ta tradhtojë burrin e vet, vret gruan e pabesë dhe plagos në krah armikun turkoshak, në mënyrë që ai «gratë e botës mos t'i çikë më me duar...» Vjersha u shqipërua nga origjinali rumanisht.

e në valë e hjedh të bjerë
që nga bregu te Despina.
Grushtat Gjergji n'mal shtrëngon,
buzën egër dhëmbë e bren
edhe idhtaz turfullon.

Biri i pashës nga Janina
prej gëzimit krahët shtrin,
kur afron ngadalë e arrin
zambakun mbi lum Despina.
Lulen n'parzëm ajo vë?
Por dhe Gjergji vrik në kreshtë
karabinës plumb i shtje.

Biri i pashës nga Janina
ëmbëlsisht miklon te balli
bukurushën, veç nga mali
solli vdekjen karabina:
as të riut, as kalit t'tij,
por zambakut plumbi i vajti
q'e pabesa e vu në gji.

Biri i pashës nga Janina
brezin lidh, këcen mbi shalë,
rreh marrzisht me fre mbi kalë,
veç e zuri karabina:
jo në gjoks me ar praruar,
por në krah, që gratë e botës
mos t'i çikë më me duar...

KORRADO LUSKI

JE E LIRË*)

E kuqe ishte Vjosa
kur vdiste alpini,¹⁾
e shkretë Tepelena
kur euzoni²⁾
ngulte sytë e vet
drejt Atdheut të largët.

*) Autori e shkroi këtë vjershë pas një vizite miqësore që bëri nëpër vendin tonë. Në hyrje, ai aludon për luftën e padrejtë që fashizmi italian bëri kundër popullit shqiptar dhe popullit grek. Vjersha u shqipërua nga origjinali italisht.

1) ushtari fashist italian alpin

2) ushtari grek nga Kreta, i përfytyruar me fustanellë

Ku ishin shigjetat,
shpata e Skëndërbeut?
Në shtizën e shqiptarit,
në duar punëtore e fshatare.

U zhduk ylberi:
e mbetën vetëm
e kuqja dhe e zeza,
jeta dhe vdekja,
ulërима e të torturuarit.

«Got mit uns!»³⁾
Tha xhelati⁴⁾
mbi kryqe dhe të varur
të të gjitha fshatrave.

Sot,
lumenjtë shqiptarë
murmurojnë nga fitore rrezatuese
që Tomori ua përcjell
Lindjes dhe Perëndimit.

3) «Zoti me ne!», në gjermanisht

4) aludohet në figurën e vrasësit fashist gjerman

Pasqyrë e punës
janë kombinatet e kooperativa,
muze e biblioteka,
toka e qielli.

O e vogla, e madhja Shqipëri,
shembulli i martirëve të tu
e i vllëzërve të mi partizanë
ka përmbushë mrekullinë.

Je e lirë,
një dhe e pandarë,
përvijuar në të nesërmen
të sigurtë e të bardhë.

GJAKU YNË*)

Brez pas brezi, dor' më dorë,
s'humbi gjaku ynë arbror.
Edhe pse në botë u shprish,
mbeti prap' ai që na ish.
Mot pas moti erdh e shkoi,
zemra jonë por s'harroi
male e pyje t'atij Dheu,
ku luftonte Skëndërbeu.
Na qesh zemra me hare
kur dëgjojmë këngët sot
ngritur Shqipëris' së re, —
vjersha thurrë trimërisë,
që ia ngrej në jetë e mot
lart lavdinë Shqipërisë.

*) Vjersha është botuar te «Albania oggi» («Shqipëria sot»), Romë, 1975, Nr. 3, f. 34. Autorët e saj janë arbëreshë, miq të Shqipërisë. Titulli është nxjerrë nga vargu i dytë i vjershës. Vjersha u suall në shqipen e sotme nga origjinali arbërisht.

PËRMBAJTJA

Shqipëri!	3
Burim poezie	5
Kanonierët	6
Marshi i Brigadës së 27-të Sulmuese	7
Rrapi	8
Mirënjohje	9
Rrugëza e blinjve	10
Te Mitri i Koronës	11
Kangjelet	13
Në Vila Badesa	15
Buzë Arnos	16
Betimi i palestinezit	20
Irlanda e Veriut, për ju skëterrë	21
Për ty, Brazil!	22
Kolona	24
Mësuesit ushtar	26
Domën	28
Balada e peshkatarit	30
Dashuri	33
I-moshuari dhe e mitura	34
Bluza, trikoja dhe graniti	36
E brishta	38
Kriza	39

Eksod	40
Thellësitë	41
Ku veni ju, mendime?	42
Monumenti	44
Zogjtë	45
Konture epike	46
Në kuvendin e poezisë	47
Pranvera e shokëve të mi	49

Shqipëri me

JERONIM DE RADA: Një admiruesi të Dora d'Istrias	53
VINÇENC STRATIGOI : Proletari	55
FILIP SHIROKA : Në kambë, Shqypni!	60
VIKTOR EFTIMIU : Ju mbart të gjithëve	63
GJORGJ KOSHBUKU : Baladë shqiptare	64
GJON LIKURSI dhe ZEF KAMODEKA : Gjaku ynë	69

VEPRA LETRARE TË AUTORIT

1. Shtigje drite, përmbledhje vjershash, Shkodër, 1946
2. Vjersha, përmbledhje vjershash, Tiranë, 1954
3. Përrallëza dhe gjëza për fëmijë, Tiranë, 1954.
4. Gjak u falun, poemë, Tiranë, 1955
5. Përrallëza për fëmijë, Tiranë, 1956
6. Një përrallë e vërtetë, poemë, Tiranë, 1957.
7. Poezia e rrugës, përmbledhje vjershash, Tiranë, 1959.
8. Në rrjedhën e jetës, përmbledhje vjershash, Tiranë, 1969.
9. Jeta e Elena Gjikës — Dora d'Istrias, portret monografi, Tiranë, 1967
10. Jeta e Faq S. Nolit, portret monografi, Tiranë, 1972
11. Migjeni, portret monografi, Tiranë, 1974